

Statuti i një Shoqërie - Biznes i Vogël

Në bazë të Ligjit Nr.9901, datë 14/04/2009 “Për Tregtarët Shoqëritë Tregtare”, Themeluesi nxjerr:

STATUTIN

E

QUALITY AND CARE.

QUALITY AND CARE

Rruga Beqir Luga, Pallati 3, Zona 81/50, Tiranë..

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Me këtë Statut rregullohen këto çështje:

- emërtimi i Shoqërisë,
- lloji i shoqërisë,
- adresa e selisë së saj,
- periudha e kohëzgjatjes,
- veprimtaria e shoqërisë,
- llojet e aksioneve të autorizuara për emetim, vlerën e tyre nominale, numrin dhe të drejtat e bartësve të tyre,
- organet drejtuese,
- emrat dhe adresat e themeluesve dhe
- procedurat me të cilat mund të ndryshohen rregulloret.

Neni 2

EMËRTIMI I SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA



Emërtimi i plotë i shoqërisë është: Shoqëria Tregtare **QUALITY AND CARE**

Shkurtimisht: **QUALITY AND CARE**

Neni 3

LLOJI I SHOQËRISË

Shoqëria Tregtare është **Biznes i Vogël**, shkurtimisht **QUALITY AND CARE**

Neni 4

ADRESA E SELISË

4.1. Selia e **QUALITY AND CARE** është në **Rruga Beqir Luga, Pallati 3, Zona 81/50, Tiranë,**

4.2. **Përfaqësues i autorizuar** i kësaj shoqërie tregtare është **FLUDIAN ÇUKA**, , i cili është përfaqësues i ligjshëm për pranimin e shërbimeve, njoftimeve, kërkesave si dhe akteve tjera që derdohen nga autoritetet publike.

4.3. Shoqëria mund të themeloi filiala, zyra përfaqësimi brenda vendit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

QËLLIMI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

Qëllimi i themelimit të Shoqërisë është qëllim i ligjshëm afarist, si dhe përfitimi personal dhe ndihma vendit ku jetojnë me kontribute dhe taksa të ndryshme



Neni 6

PERIUDHA E KOHËZGJATJES SË SHOQËRISË

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë si **QUALITY AND CARE** do të jetë në afat të pacaktuar.

Neni 7

VEPRIMTARIA E SHOQËRISË

Veprimtaria e Shoqërisë është:

- **Importi dhe Tregtia me shumicë dhe pakicë e ushqimit të kafshëve shtëpiake**
- **Importi dhe Tregtia me pakicë dhe shumicë e ushqimeve, aksesorëve, suplementeve, shampove, për kafshët shtëpiake dhe kuajt e fermave**
- **Tregtia me pakicë e mallrave të tjera të reja, në dyqane të specializuara**

Të gjitha veprimtaritë e Shoqërisë regjistrohen tek Zyra e regjistrimit e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës.

Neni 8

THEMELUESIT E SHOQËRISË

8.1. Themeluesit e shoqërisë mund të jenë persona fizik ose juridik, që kanë vënë ose do të kenë në zotërim aksione të shoqërisë, me të gjitha mënyrat e parashikuara me ligj.

8.2. Kapitali i përgjithshëm i shoqërisë tregtare është 10,000.00€



8.3. Themelues janë:

FLUDIAN ÇUKA - TIRANE, TIRANE, Rr.Tefta Tashko, pjesa në pronësi 100%

8.4. Pronësia mbi aksionet e shoqërisë, përmban aderimin me të drejta të plota në statutin e shoqërisë nëpërmes përfaqësimit në Kuvendin e Aksionarëve.

Neni 9

TË DREJTAT DHE DETYRAT E THEMELUESVE

9.1. Interesat pronësore që mund të quhen “aksion” në **Biznes i Vogël** janë njësitë në bazë të cilave bëhet ndarja e pronësisë në shoqëri.

9.2. Një interes pronësor në **Biznes i Vogël** është pronë personale e pronarit dhe mund të bartet pjesërisht ose në tërësi, varësisht nga kufizimet e parapara në këtë Statut dhe kufizimet e tjera të përcaktuara në Marrëveshjen e shoqërisë.

9.3. Themeluesit e shoqërisë janë përgjegjës për të gjitha borxhet e shoqërisë dhe detyrimet e tjera me të tëra asetet.

9.4. Të gjithë themeluesit apo ndonjeri prej tyre që ndërmarrin veprim në emër të **Biznes i Vogël** duke bërë hapjen e xhirollogarive bankare, blerjen dhe dhënjën me qira të pronës, lidhjen e kontratave ose ndërmarrjen e detyrimeve tjera, janë bashkërisht dhe personalisht përgjegjës për pretendimet dhe detyrimet që lindin si rezultat i këtyre veprimeve.

9.5. Çdo aksionar ka të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e shpërndashme të shoqërisë dhe përfiton proporcionalisht me shumën e aksioneve që zotëron .

9.6. Çdo vonesë në derdhjen e shumave të duhura nga shumat e pashlyera të aksioneve sjell pagimin e interesave, me përqindjet ligjore dhe kjo pavarësisht nga veprimet personale që shoqëria mund të ushtroj ndaj aksionarit që nuk ka shlyer detyrimin dhe nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.



Neni 10

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- 1.Kuvendi i aksionarëve
- 2.Drejtori apo Drejtorët Menaxhues.

Shoqëria mund të krijoj dhe mbajë edhe një Bord të drejtorëve.

Neni 11

Kuvendi i aksionarëve

11.1. Kuvendi i aksionarëve, qoftë i zakonshëm apo i jashtëzakonshëm ka kompetenca dhe merr të gjitha vendimet e përcaktuara me Ligjin për shoqëritë tregtare ose Statut.

11.2. Kuvendi i aksionarëve do të mbahet në zyrën e regjistruar të shoqërisë ose në një vend tjetër të caktuar më parë me paralajmërimin për mbledhje.

Neni 12

E drejta e votës

12.1. E drejta e votës rrjedh nga zotërimi i aksioneve që përfaqësojnë dhe çdo aksion të jep të drejtën e të paktës një(1) vote.



12.2. E drejta e votës që rrjedh nga përfaqësimi, kërkon një mandat përfaqësimi të shkruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 13

Drejtimi i mbledhjeve të Kuvendit

13.1. Thirrja e mbledhjes së Kuvendit bëhet:

- nëpërmes njohtimit të dërguar me letër rekomande në adresën e çdo aksionari me shpenzimet e shoqërisë apo

- në mënyrë elektronike në email adresat e aksionareve ku patjetër duhet konfirmimi.

13.2. Mbledhjet e Kuvendit të aksionarëve ,drejtohen nga një Kryesues i caktuar nga Kuvendi.

13.3. Gjithashtu mbledhjen e Kuvendit mund ta drejtojnë personat që kanë autorizim e në pajtueshmëri me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

13.4. Kryesuesi cakton një procesmbajtës për të mbajtur procesverbalin lidhur me pikat e rendit të ditës.

Neni 14

Procesverbalet e mbledhjes së Kuvendit

14.1. Procesverbalet e mbledhjes së Kuvendit, duhet të mbahen në përputhje me kërkesat e Ligjit për shoqëritë tregtare dhe detyrimisht në fund të saj ,duhet të nënshkruhen nga Kryesuesi dhe procesmbajtësi.

14.2. Kuvendi i jashtëzakonshëm mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë në mbledhjen e parë të paktën $\frac{1}{2}$ e aksioneve dhe në të dytën $\frac{1}{4}$ e aksioneve me të drejtë vote. Në mungesë të këtij kuorumi mbledhja e dytë e Kuvendit



mund të shtyhet për një datë të mëvonshme jo më të largët se dy muaj nga data e thirrjes së parë. Ajo merr vendim me një shumicë votash prej $\frac{3}{4}$ që u përkasin aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

14.3. Kuvendi i zakonshëm merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë, vetëm nëse aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë $\frac{1}{4}$ e aksioneve me të drejtë vote. Në rast se kjo mbledhje nuk realizohet, në të dytën nuk kërkohet asnjë lloj kuorumi.

14.4. Kuvendi i zakonshëm merr vendim me shumicën e votave që zotërojnë aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar.

Neni 15

E drejta për të u njohur me dokumente

Drejtori menaxhues duhet të paktën 8 ditë para ditës së caktimit të mbledhjes së Kuvendit të iu dërgojë dokumentet e nevojshme aksionerve për tu njohur dhe për të dhënë një gjykim të plotë, mbi administrimin dhe ecurinë e punëve të shoqërisë në fund të vitit, raportet mbi aktivitetin e shoqërisë, raportin e ekspertit të kontabilitetit, raportin e Këshillit mbikëqyrës, të gjitha projekt vendimet dhe konkluzionet si dhe të gjitha dokumentet tjera të parapara me "Ligjin për Shoqëritë Tregtare".

Neni 16

NËPUNËSIT E SHOQËRISË

16.1. Nëpunësit e Shoqërisë zgjedhen nga Drejtori menaxhues. Shoqëria nuk mund të ketë më pakë se dy nëpunës.

16.2. Kompetencat e nëpunësve parashihen me aktet normative të Shoqërisë si dhe në marrëveshje me Drejtorin menaxhues sipas dispozitave të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe ligjeve tjera relevante.



Neni 17

DREJTORI MENAXHUES

17.1. **Drejtor menaxhues i Shoqërisë** emrohet **FLUDIAN ÇUKA - TIRANE, TIRANE, Rr. Tefta Tashko** i cili do të ushtroi funksionet e tij/saj nën kontrollin e Kuvendit të aksionarëve. Fludian Cuka do jete Administrator për një afat 5 vjecar.

17.2. Drejtori menaxhues mund të shkarkohet për shkaqe të cenimit të ligjit nga Kuvendi i aksionarëve. Si shkaqe të cenimit të ligjit konsiderohen veçanërisht një faj i rëndë i Drejtorit menaxhues, pa aftësia e tij në kryerjen korekte të funksioneve ose kur Kuvendi humb besimin tek ai.

Neni 18

Kompetencat dhe kufizimet

18.1 Drejtori menaxhues ka këto kompetenca:

- të paraqitet, përfaqëson dhe nënshkruan për shoqërinë,
- të ekzekutoi Vendimet e Kuvendit,
- të udhëheq afarizmin e shoqërisë,
- të organizon dhe udhëheq me procesin e punës,
- përgatit pasqyrat vjetore te kontabilitetit dhe raportet mbi afarizmin,
- propozon Vendimet të cilat i nxjerr Kuvendi,
- propozon organizimin e brendshëm të shoqërisë,
- i pranon në punë dhe iu shkëput Kontratën e punës punëmarrësve,
- vendos mbi sistemimin e punëmarrësve në vende pune,
- kujdeset për ligjshmerine e punës në shoqëri,
- vendos mbi procedurat disiplinore të të punësuarve,
- kryen edhe punë të tjera në harmoni me ligjin, Statutin dhe Vendimet e Kuvendit.

18.2. Drejtori menaxhues si përfaqësues i shoqërisë është i autorizuar të lidhe Kontrata dhe kryej të gjitha veprimet tjera juridike pa kurrfarë kufizimesh.



Neni 19

Përfaqësimi

Nga ana ligjore, Shoqëria përfaqësohet nga drejtori menaxhues (administrator).

Neni 20

NDARJA, BASHKIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet, likuidohet ose transformohet në një formë tjetër, përpara afatit të përcaktuar, me vendim të mbledhjes së jashtëzakonshme të aksionerve, në përputhje me parashikimet e “Ligjit për shoqëritë tregtare”.

Neni 21

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

21.1. Ky Statut hyn në fuqi ditën që e aprovojnë Themeluesit e Shoqërisë.

22.2. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti bëhen sipas procedurës së njejtë si është aprovuar.

23.3. Për të gjitha qështjet që nuk janë përcaktuar me këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Data: **09/06/2021**

Vendi: **Rruga Beqir Luga, Pallati 3, Zona 81/50, Tiranë,.**

Themeluesi:

1. FLUDIAN ÇUKA

